



VENDIM

Nr. 2, Datë 10/05/2018

PËR

MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURISIT TË
PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019,
TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të, Nenit 38-Funksionet e Senatit Akademik, *e vijim* - të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", shkresës Nr. 488 prot., datë 20.12.2017, të Fakultetit të Artit Skenik, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi "Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2018-2019, të Fakultetit të Artit Skenik, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve" relatuar nga Dekani i FAS, Prof. Petrit Malaj,

VENDOSI

1. Miratimin e "Rregulloreve dhe Kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2018-2019, të Fakultetit të Artit Skenik, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë "Bachelor" dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve".
Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë me kohë të plotë "Bachelor" si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë "Master i Arteve", të Fakultetit të Artit Skenik.
2. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të UART.
3. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MAS si dhe të përditësohen në portalin UALBANIA.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Milto KUTALI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Najada HAMZAJ



Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Asoc. Elvis RUDI

Nansy GJERAZI

Prof. Vladimir MYRTEZAI (GROSHA)

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Rafael HOXHA

Nr. 488 prot.

Tiranë, më 20.12. 2017

Lënda: Dërgohen për miratim në Senatin Akademik kriteret e konkurseve të pranimit dhe rregulloret përkatëse për vitin 2018-2019.

Drejtuar: REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE
Prof. Kastriot ÇAUSHI
ZV/REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE
Prof.Dr. Erald BAKALLI

Të nderuar zotërinj,

Mbështetur në shkresën tuaj me nr. 1687/2 prot. datë 15.12.2017 po ju dërgojmë për miratim në Senatin Akademik kriteret e konkurseve të pranimit dhe rregulloret përkatëse për dy ciklet e studimeve për vitin akademik 2018-2019.

Përgjegjësit e departamenteve kanë dërguar shkresat përkatëse lidhur me këtë rast të cilat po i dërgoj bashkangjitur.

Në rregulloren e konkursit të pranimeve për ciklin e dytë të studimeve ne kemi vendosur në emërtesë dhe termin **mësuesi**. Kjo në varësi të vendimit përkatës të senatit akademik ku është vendosur "Master i Arteve dhe mësuesi". Do kërkoja vëmendje për këtë moment pasi është e nevojshme të merret dhe vendimi përkatës nga strukturat e MAS e më pas të vepohet edhe nga ana jonë.

Materialet do dërgohen te zv.rektori edhe në formë elektronike nga sekretaria mësimore e fakultetit.

Faleminderit!

Prof. Petrit MALAJ

DEKAN

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

R R E G U L L O R E

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT
NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË
"MASTER I ARTEVE DHE MESUESI "
NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE
PËR VITIN AKADEMIK 2018 – 2019**

MIRATUAR ME VENDIM NR 2, DATË 10/04.2018

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë, në Republikën e Shqipërisë", Kreu VII, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 76, "Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve", si dhe mbështetur në Rregulloren e UART të ciklit të dytë të studimeve, konkurset e pranimit në Fakultetin e Artit Skenik për vitin akademik 2017-2018 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1** Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, bëhet me konkurs mbi bazën e rezultateve të konkurseve që zhvillohen për studimet në ciklin e dytë të studimeve "Master i Arteve" pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj rregulloreje si dhe kritereve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 1.2** Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta "Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja", do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3** Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, posaçërisht për trojet Shqiptare.

Neni 2

Kriteret e pranimit

- 2.1** Pranimi në programet e ciklit të dytë MASTER I ARTEVE DHE MESUESI është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe zotërojnë diplomën BACHELOR.
- 2.2** Kandidatët mund të kenë kryer programin e studimit të ciklit të parë Bachelor pranë këtij fakulteti ose në Fakultete të tjera si brenda dhe jashtë vendit.
- 2.3** Pranohen të gjithë ata kandidatë që kanë kryer studimet në ciklin 4-vjeçar në fakultetin e Artit Skenik. Gjithashtu edhe ato kandidatë të ciklit 4-vjeçar, të fakulteteve të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- 2.4** Nota mesatare e kandidatëve preferohet të jetë mbi 7.(e ponderuar)
- 2.5** Për konkurrentët që kanë kryer studime jashtë vendit duhet bërë paraprakisht njehsimi i Diplomës në strukturat përkatëse të MASR.
- 2.6** Baza e konkurrimit për kandidatët në të gjitha programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Artit Skenik për studime në ciklin e dytë të studimeve "Master i Arteve dhe mësuesi", janë kriteret e miratuara nga departamentet përkatëse si dhe nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.

- 2.7** Konkurrimi për këtë cikël studimesh ka në bazë **dy faza**:
Faza e parë: *shqyrtimi i dosjes së kandidatit*.
Faza e dytë: *bashkëbisedim me kandidatët*.
- 2.8** Kandidatët për programin e studimit "Master i Arteve dhe mësuesi", për vlerësimin e Fazës së parë duhet të dorëzojnë pranë Fakultetit të Artit Skenik, dosjen personale të konkurrentit ku të jenë të përfshira:
- I. CV e tij/e saj,
 - II. Diploma Bachelor ose e sistemit 4 vjeçar,
 - III. Lista origjinale e notave të programit të studimit të kryer,
 - IV. Dëshmi mbi rezultatet e arritura në procesin e realizimit të programit mësimor,
 - V. Projekte,
 - VI. Shfaqje,
 - VII. Filma,
 - VIII. Ekspozita, etj.
- 2.9** Dosja duhet të përmbajë dëshmitë e aktiviteteve artistike, si brenda dhe jashtë shkollës:
- I. Postera,
 - II. Fletë palosje,
 - III. Fotografi,
 - IV. Dhe çdo material tjetër që dëshmon aktivitetet artistike të konkurrentit.
- 2.10** Kandidatët që kanë kryer programe të tjera studimi, jashtë Fakultetit të Artit Skenik, brenda dhe jashtë vendit do të kenë dhe një intervistë me komisionin e pranimit.
- 2.11** Për çdo sqarim tjetër në lidhje me konkursin, programet e studimit si dhe me plotësimin e krediteve, drejtohuni pranë Fakultetit të Artit Skenik.

Neni 3

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 3.1** Dekani i Fakultetit, mbështetur në propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 3.2** Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 3.3** Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
- I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij neni.



- 3.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 3.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Artit Skenik .
- 3.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Artit Skenik. Po ashtu konkursi monitorohet dhe nga përfaqësuesit e MASR.

Neni 4

Procedura e konkurrimit.

- 4.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e Nenit 2, të kësaj rregulloreje.
- 4.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët që janë regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Artit Skenik, brenda afatit të përcaktuar nga MASR.
- 4.3 Konkursi për Fakultetin e Artit Skenik do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MASR.
- 4.4 Komisionet e pranimit do të marrin në shqyrtim vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim nga sekretaria mësimore.
- 4.5 Në momentin e regjistrimit kandidati duhet të paraqesë:
 - I. *Kartë Identiteti ,*
 - II. *Pasaportë për jashtë shteti.*
 - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 4.6 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të ketë bërë pagesën e përcaktuar, në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.
- 4.7 Në varësi të numrit të kandidatëve për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite. Oraret bëhen të ditura më parë dhe shpallen në ambientet e Fakultetit .
- 4.8 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik.
- 4.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, dosjet përkatëse si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 4.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet kur e shohin të nevojshme krijojnë tërë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve.

Neni 5
Mënyra e Vlerësimit

- 5.1** Vlerësimi maksimal për çdo konkurrent është gjithsej **100 pikë**.
- 5.2** Vlerësimi maksimal i Fazës së I të konkurrimit mbi shqyrtimin e dosjes është **60 pikë**.
- 5.3** Vlerësimi maksimal i Fazës së dytë të konkurrimit bashkëbisedim me kandidatët është **40 pikë**.

Neni 6
Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 6.1** Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhet nga Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 6.2** Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).
- 6.3** Gjatë shqyrtimit të dosjeve të kandidatëve anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë gjatë fazës së bashkëbisedimit ka të drejtë t'i drejtojë kandidatit që konkurren pyetje konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 6.4** Në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mblidhet për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 6.5** Pikët maksimale për vlerësim janë 100.
- 6.6** Secili anëtar i komisionit të pranimit vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 6.7** Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 6.8** Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 6.9** Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal në sekretarinë e Fakultetit.
- 6.10** Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë.



Neni 7 **Shpallja e fituesve**

- 7.1 Shpalljen përfundimtare për fituesit e bën Dekani i Fakultetit mbi bazën e kuotave të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve.
- 7.2 Në rastin kur disa konkurrues kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata renditen midis tyre duke marrë si bazë notën mesatare të ponderuar.

Neni 8 **Regjistrimi për të fituar statusin e studentit**


- 8.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 8.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**.
- 8.3 Ato duhet të jenë:
 - I. Diploma Bachelor
 - II. Për kandidatët shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, dokumentet e mësipërme duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe e të noteruara.
 - III. Kartë identiteti,
 - IV. Pasaportë,
 - V. 2 (dy) fotografi
 - VI. Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit që caktohet nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.
- 8.4 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 8.5 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç' regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 8.6 Kandidatit që çregjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 8.7 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Rinisë.

Neni 7
Rregulla për kandidatët

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 9.1** Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Artit Skenik.
- 9.2** Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimi të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit. Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 9.3** Komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 9.4** Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

Përgjegjësi i Departamentit Aktrim-Teori Arti
Prof. asoc.dr. Elida RAPTI



Përgjegjësi i Departamentit Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi
Prof. Ilir MARTINI



Përgjegjësi i Departamentit Regji dhe Regji Filmi dhe TV
Prof. Miltiadh KUTALI



DEKANI

Prof. Petrit MALAJ

